



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria e Arsimit

Nr. 570/23

Datë: 04.07.2023

Bazuar në nenin 62 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në nenin 4, paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

KONKURS

Për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Komunës së Vushtrrisë për vitin edukativ 2023/2024

Grup-mosha	IP “Foleja 1”	IP “Foleja 2”	IP “Foleja 3”
1- > 2 vjeç	12	7	10
2- > 3 vjeç	2	4	14
3->4 vjeç	5	3	18
4- >5 vjeç	3	0	20
5->6 vjeç	0	0	22
Gjithsej	22	14	84

Konkursi do të jetë i hapur prej datës **4 korrik, deri me 19 korrik 2023.**


Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve behet ne Institucionin Parashkollor përkatës çdo dite pune prej orës 09:00 deri ne ora 15:00.

Shpallja e rezultateve behet me date **20 korrik 2023**, ne institucionet parashkollor përkatës.

Regjistrimi i fëmijëve ne Institucionet Parashkollore behet bazuar ne Kriteret e Regjistrimit te përcaktuara nga Drejtoria Komunal e Arsimit (DKA), sipas vendimit nr. 571/23 dt. 04.07.2023.

Te gjithë te pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund te ushtrojnë ankese ne Institucionin Parashkollor përkatës dhe nëse serish janë te pakënaqur me vendimin e institucionit, atëherë mund te ushtrojnë ankese ne DKA. **DKA nuk e shqyrton asnjë ankese nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim ne ankesën e ushtruar ne komisionin e Institucionit Parashkollor përkatës.**




Dardan Abazi
Drejtore i DKA-së